

**Vendim nr. 183 datë 10.07.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                   |           |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Ilir Toska,       | Anëtar    |
| Marjana Semini,   | Anëtare   |

në datën 10.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **DILAVER BASHA**, përfaqësuar nga avokat Erdi Prifti, me prokurë të përgjithshme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 36, datë 02.03.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 317, datë 28.12.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-130, datë 30.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 11, 18, 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 1, 6 dhe 45 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 49, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi ka marrë një kredi bankare pranë bankës “Societe Generale Albania”, sot OTP Bank (*banka*), duke vendosur si kolateral një tokë “arë” me sipërfaqe 1.544 m<sup>2</sup>. Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të kredisë nga ana e kërkuesit, banka ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 144, datë 01.06.2010, është vendosur lëshimi i urdhrit të ekzekutimit. Kërkuesi ka pretenduar se nuk ka pasur dijeni dhe ka vijuar me shlyerjen e detyrimeve ndaj bankës, duke e likuiduar plotësisht kredinë në datën 21.09.2011. Ndërkohë nga Zyra e Përmbarimit Berat është proceduar me shitjen në ankand (ankandi i dytë) të pronës në datën 30.06.2011, sipas urdhrit të ekzekutimit, përpara se të bëhej shlyerja e plotë e kredisë nga kërkuesi. Kjo shumë rezulton se nuk është kaluar as në llogari të bankës, as në llogari të kërkuesit, duke mbetur në llogarinë e Zyrës së Përmbarimit. Ndërkohë, përmbaruesi I.Ç. ka depozituar në cilësinë e provës shkresore shkresën nr. 397 prot., datë 04.07.2018, të Zyrës Përmbarimore Berat, drejtuar bankës për t'i vënë në dispozicion një numër llogarie për të derdhur shumën në fjalë, shkresë e cila, sipas kërkuesit, nuk ka mbërritur asnjëherë pranë bankës.

2. Kërkuesi së bashku me bashkëshorten kanë paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Shkallës së Parë Berat me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të ankandit të zhvilluar në datën 30.06.2011 nga ana e të paditurit, Zyra e Përmbarimit Berat dhe detyrimin e tij që të pushojë ekzekutimin. Me vendimin nr. 247, datë 20.02.2012, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 780, datë 11.07.2012, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2015-667, datë 19.03.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

3. Po kështu, kërkuesi dhe bashkëshortja i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi me objekt pavlefshmërinë e të gjithë procedurës përmbarimore për pasurinë tokë “arë”, me sipërfaqe 1.544 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin Havaleas, njësia administrative Kozarë, Bashkia Kuçovë, fshirjen e kësaj pasurie në emër të të paditurit, shtetasit A.M. dhe regjistrimin në emër të paditësve. Me vendimin e datës 12.06.2017 kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

4. Kërkuesi në vitin 2012 ka paraqitur kallëzim penal kundër përmbaruesit gjyqësor, i regjistruar me numrin 513, i cili është pushuar me vendimin e datës 03.06.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Ndonëse ky vendim është ankimuar nga kërkuesi në të gjitha gjykatat deri në Gjykatën e Lartë, të cilat kanë lënë në fuqi vendimin e pushimit, ai ka paraqitur një tjetër kallëzim për të cilin është vendosur pushimi me vendimin e prokurorisë së datës 22.11.2017 dhe pas ankimit në gjykatat e zakonshme ai është lënë në fuqi.

5. Në datën 18.04.2019 kërkuesi ka paraqitur përsëri kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, i cili është regjistruar me nr. 434, kundër përmbaruesit I.Ç. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP). Nga ana e prokurorisë, pas kryerjes së hetimeve, është kërkuar pushimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Kjo e fundit, me vendimin nr. 256, datë 29.06.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit, kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve. Mbi ankimin e prokurorisë dhe apelit kundërshtues të kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 35, datë 05.03.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 29.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e çështjes, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2025-120, datë 28.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në datën 25.03.2025 kërkuesi së bashku me bashkëshorten i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e këtyre vendimeve. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 146, datë 10.06.2025, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi dhe bashkëshortja e tij nuk legjitimoheshin *ratione personae*, pasi nuk justifikonin interesin real, vetjak dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, në kuptimin që vërtetimi i faktit penal të ndërhyjë drejtpërdrejt te një e drejtë themelore e tyre. Sipas këtij kolegji, e drejta e pronës është objekt i drejtpërdrejtë i proceseve gjyqësore civile dhe jo i procesit penal të kundërshtuar.

6. Në vijim, në datën 24.01.2019 kërkuesi ka paraqitur sërish kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat për të njëjtin fakt, i cili është regjistruar me numrin 449, kundër përmbaruesit gjyqësor I.Ç. për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuara respektivisht nga nenet 143, paragrafi 3, 248 dhe 135 të KP-së. Në përfundim të hetimeve, në datën 05.10.2018, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se veprimet e kallëzuara nuk përbëjnë vepër penale, por veprime juridike civile. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kallëzim kërkuesi.

7. Me vendimin nr. 36, datë 02.03.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se fakti nuk përbën vepër penale. Sipas kësaj gjykate, përmbaruesi gjyqësor ka kryer ekzekutimin e titullit ekzekutiv, veprime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor nga gjykata civile dhe nga gjykata administrative dhe janë vlerësuar në përputhje me ligjin. Po kështu, kërkuesi ka gabuar në kallëzimin për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për sa kohë ajo qëndron vetëm në ato raste kur fakti penal nuk përbën vepër tjetër penale. Ndërsa për sa i përket akuzës për kryerjen e veprës penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, gjykata ka vlerësuar se fakti i pretenduar si fakt penal nuk ekziston, pasi derdhja e shumës së realizuar nga ankandi i zhvilluar në llogarinë e Zyrës së Përmbarimit

Berat nuk përbën përvetësim të pasurisë. Edhe për sa i përket akuzës për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, gjykata ka vlerësuar se kryerja e veprimeve për ekzekutimin e titullit ekzekutiv nga përmbaruesi gjyqësor nuk përbën anën objektive të kësaj veprë, si dhe nuk provohet ana subjektive, përvetësimi i pasurisë. Ndërsa për sa i përket vendimit të mosfillimit të prokurorit, kjo gjykatë ka evidentuar se ai është marrë tej afatit 15-ditor të përcaktuar nga ligji (pas rreth 9 muajsh) dhe se prokurori në kushtet kur ka kryer hetime dhe ka marrë prova, domosdoshmërisht duhet të kishte regjistruar procedimin penal dhe më pas të kryente veprimet që ka kryer. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në kushtet kur prokurori ka arritur në përfundimin se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale, ajo çmon të rrëzojë ankimin e kërkuarit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar.

8. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 317, datë 28.12.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se ai është i bazuar në prova e në ligj dhe shkaqet e ankimit janë të pambështetura. Kjo gjykatë ka pranuar se veprimtaria e prokurorit është shtrirë jashtë afatit 15-ditor dhe ai duhej të kishte regjistruar procedimin dhe më pas të kryente të gjitha veprimet verifikuese, në përfundim të të cilave ai mund të kërkonte pushimin e akuzës ose çështjes. Pavarësisht këtij fakti, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova, pasi faktet e kallëzuar nga kërkuar përbëjnë elemente të një mosmarrëveshjeje juridiko – civile, e cila është gjykuar si nga gjykatat civile ashtu edhe nga ato administrative. Për më tepër, kjo gjykatë ka evidentuar se kërkuar ka bërë edhe kallëzime të tjera për të njëjtin fakt, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti nuk përbënte vepër penale. Sipas saj, edhe pretendimi se i kallëzuar nuk ka dërguar në bankë shkresën për vënien në dispozicion të numrit të llogarisë nuk përbën vepër penale, pasi shuma e marrë nga shitja e kolateralit është në llogarinë e përmbaruesit. Po kështu, gjykata i ka kthyer përgjigje edhe pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykatën e shkallës së parë, duke e konsideruar të pabazuar, pasi kërkuar nuk ka paraqitur asnjë provë për këtë pretendim dhe nuk ka paraqitur kërkesa për dorëheqje.

9. Për rekursin e kërkuarit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-130, datë 30.01.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ai kolegji ka arsyetuar se në rekursin e kërkuarit nuk parashtrihen pretendime rreth vendimmarrjes së gjykatës së apelit dhe se ai ka pretenduar se vendimi i prokurorisë është i pabazuar, pasi duhet të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, ndërkohë që ky pretendim është marrë në shqyrtim nga gjykatat. Po kështu, ky kolegji ka vlerësuar se gjykata e apelit e ka arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen e saj, duke marrë në shqyrtim

pretendimet e kërkuessit; nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

10. Në datën 19.05.2025 kërkuessi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

## II

### Pretendimet e kërkuessit

11. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

11.1.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* të lidhur me parimin e sigurisë juridike, pasi gjykatat e zakonshme megjithëse kanë konstatuar se veprimet e prokurorit janë në shkelje të ligjit procedural penal, konkretisht të nenit 291 të KPP-së (jashtë afatit 15-ditor), nuk e kanë shfuqizuar atë.

11.1.2. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë është shprehur edhe me vendimet nr. 00-2023-974, datë 13.06.2023 dhe nr. 00-2025-120, datë 28.01.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ky gjyqtar ka shfaqur mendim juridik pjesërisht për këtë çështje penale.

11.1.3. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore nuk shprehen për shkaqet e ankimit dhe rekursit. Nga ana e organit të akuzës nuk u ndërmor asnjë hap për kryerjen e hetimit, ndonëse ai duhet të tërhiqte dosjen dhe të verifikonte veprimin e kundërligjshëm të përmbaruesit, i cili nuk ka dërguar në bankë shkresën “kërkesë për vënien në dispozicion të numrit të llogarisë”.

11.2. *E drejta e pronës*, e parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi megjithëse kërkuessi ka likuiduar bankën për kredinë e marrë, përsëri prona e tij është shitur në ankand nga zyra e përmbarimit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesës

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për ankimin e tij kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal në bazë të kallëzimit të paraqitur nga ai. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale kërkuuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

14. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

15. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor i cili në thelb ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin e tij ndaj përmbaruesit gjyqësor, për shkak të shitjes në ankand të pronës së tij të lënë kolateral më parë në bankë. Në përfundim të hetimeve prokuroria ka vlerësuar se veprimet e kallëzuara nuk përbëjnë vepër penale, por veprime juridike civile, arsyetim i cili është pranuar

nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit dhe në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit. Ndonëse këto gjykata kanë pranuar faktin se vendimi i prokurorit është marrë tej afatit ligjor 15-ditor dhe ai ka kryer veprime hetimore pa regjistruar procedimin penal, ato kanë arritur në konkluzionin e përbashkët se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale, por elemente të një mosmarrëveshjeje juridiko-civile. Nga ana tjetër, kërkuari ka kundërshtuar në gjykatat e zakonshme procedurën e zhvillimit të ankandit të shitjes së pronës së tij, si dhe të gjithë procedurën përmbartimore, kërkesa të cilat janë rrëzuar nga gjykatat.

16. Për sa më lart, Kolegji vëren se ndonëse në themel të pretendimeve të kërkuarit qëndron e drejta e pronës, ajo nuk lidhet drejtpërdrejt me procesin penal të vënë në lëvizje nëpërmjet kallëzimit kundër përmbartuesit gjyqësor që ka zhvilluar procedurën e ankandit për shitjen e pronës së tij. Sikurse konstatohet nga vendimet objekt kundërshtimi, e drejta e pronës së kërkuarit është trajtuar nga gjykatat e zakonshme si në procesin civil ashtu edhe administrativ, të cilat kanë përcaktuar se përmbartuesi gjyqësor ka ushtruar detyrën në përputhje me ligjin dhe në kushtet e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se ky kallëzim penal i kërkuarit nuk mund të ndryshojë konkluzionin e gjykatave për mosmarrëveshjen civile dhe të ndikojë në të drejtën e pronës të pretenduar prej tij. Pra, vendimet objekt kundërshtimi në rastin konkret nuk mund të sjellin pasoja në të drejtën e pronës për sa kohë ajo është objekt i drejtpërdrejtë i proceseve gjyqësore civile dhe jo i procesit penal të kundërshtuar.

17. Bazuar në këto konsiderata, Kolegji çmon se kallëzimi penal ndaj përmbartuesit gjyqësor nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuarit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

18. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.